

Dokumenti i informacionit kryesor

Ky dokument përmban informacionin kryesor të investitorit për këtë produkt të caktuar investimi. Ky dokument nuk shërben për qëllime marketingu. Publikimi i informacionit kërkohet me ligj për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën e produktit, rreziqet e tij, kostot dhe fitimin/humbjen që mund të gjenerohet nga përdorimi i tij, si dhe për ta krahasuar produktin me produkte të tjera.

Fondi ombrellë mbrojtës me shumë asete në OTP

(Kuotat e Fondit të serisë "A", kodit ISIN: HU0000729793 Monedha: EUR)

<p>Shoqëria Administruese e Fondit: OTP Fund Management Ltd., një anëtar i "OTP Group"</p> <p>Faqja e internetit: https://www.otpalapkezelzo.hu/en/home</p> <p>Për më shumë informacion: levelek@otpalap.hu ose +36-1-412-8300 (në ditët e punës, mes orës 08:00 dhe 16:00)</p> <p>Dokument i datës: 20 Maj 2026</p> <p>Data e hyrjes në fuqi të dokumentit: 01 Qershor 2026</p>	<p>Për sa i përket këtij Dokumenti të Informacionit Kryesor, OTP Fund Management Ltd. mbikëqyrret nga "Magyar Nemzeti Bank" (Banka Kombëtare e Hungarisë, www.mnb.hu). OTP Fund Management Ltd. është një shoqëri administruese e fondeve të investimit, e cila është licencuar në Hungari dhe mbikëqyrret nga "Magyar Nemzeti Bank". Fondi është një fond i harmonizuar sipas Direktivës UCITS (UCITS), i licencuar në Hungari dhe i mbikëqyruar nga "Magyar Nemzeti Bank".</p>
---	--

Shënim! Ju po blini një produkt kompleks, i cili mund të jetë i vështirë për t'u kuptuar

Fondi rekomandohet për klientët që pranojnë një rrezik mesatar-të ulët me qëllimin që të zbatojnë objektivat financiarë afatmesëm si pjesë e një portofoli investimi me shumë produkte. Ky Fond mund të mos jetë i përshtatshëm për investitorët që dëshirojnë t'i tërheqin paratë e tyre nga Fondi brenda 4 vitesh.

Çfarë lloj produkti është ky?

Loji i Fondit: Një fond investimi i hapur publik i harmonizuar në përputhje me Direktivën UCITS, i krijuar për një afat kohor të pacaktuar. Fondi nuk paguan asnjë kthim mbi fitimet kapitale. Të gjitha fitimet kapitale rinvestohen.

Maturimi: Fondi është krijuar për një periudhë kohore të pacaktuar. Vendimi për të nisur procedurat e mbylljes kundrejt Fondit merret nga Shoqëria Administruese e Fondit ose nga Autoriteti i Mbikëqyrjes. Është e detyrueshme nisja e procedurave në rastet e renditura në nenin 75, paragrafi 2, germa "a-e" të Kbtv-së.

Kodi LEI: 23300075A03123U37E23

Depozitari i Fondit: UniCredit Bank Hungary Zrt.

Indeksi referencë: Fondi nuk ka indeks referencë.


Objektivat e investimit: Fondi është një fond miks me administrim aktiv të rrezikut, i cili operon në një strukturë "fond ombrellë (fond i fondeve)" dhe investon në tregjet botërore. Investimet e Fondit përbëhen nga Kuotat e Fondit të fondeve të investimit që investojnë, në pjesën më të madhe, në tregjet e zhvilluara dhe në një përqindje më të vogël në tregjet në zhvillim. Krahasuar me fondet mikse tradicionale, Fondi mund të investojë gjithashtu në instrumente alternative (fonde të pasurive të paluajtshme, fonde mbrojtëse, kuota fondi të fondeve të tregut të mallrave), çmimi i të cilave pritet të shfaqë korrelacion të ulët, pra lidhje jo të drejtë, me çmimin e instrumenteve të tjera të Fondit. Nga ana tjetër, korrelacioni i ulët mund të kontribuojë në balancimin e performancës së Fondit dhe reduktimin e luhatjeve të çmimit. Ndërkohë, përmes administrimit aktiv të rrezikut, Fondi synon të shfaqë qëndrueshmëri më të lartë, edhe gjatë periudhave të paqëndrueshme që ndodhin rregullisht në tregjet kapitale, në krahasim me fonde të tjera me një përbërje të ngjashme. Objektivi i Shoqërisë Administruese të Fondit është të garantojë që gjatë periudhës së rekomanduar të investimit, Fondi të arrijë një kthim më të lartë të rregulluar sipas rrezikut, krahasuar me fondet mikse tradicionale. Shoqëria Administruese e Fondit integron rreziqet e qëndrueshmërisë dhe administrimin e tyre në proceset e vendimmarrjes së Fondit; kështu, Fondi është në përputhje me nenin 6 të Rregullores SFDR. Fondi nuk synon të promovojë karakteristika mjedisore dhe/ose sociale (nuk bën pjesë në nenin 8, paragrafi 1 të Rregullores SFDR), ose të bëjë investime të qëndrueshme (nuk bën pjesë në nenin 9, paragrafët 1, 2 dhe 3 të Rregullores SFDR). Fondi administrohet në mënyrë aktive. Fondet përzgjidhen duke marrë parasysh treguesit cilësorë dhe sasiore në mënyrë të tillë që përbërja e portofolit të pasqyrojë nivelin e rrezikut të njoftuar për fondin në tërësi.

Kategoritë kryesore të instrumenteve financiare të kualifikueshme që përbëjnë objektin e investimit: Titujt qeveritarë dhe titujt e garantuar nga shteti, depozitat bankare, transaksionet e financimit të titujve, titujt e tjerë të borxhit, instrumentet e tregut të parasë, monedhat, instrumentet derivative, titujt e investimit kolektiv.

Investitorët e vegjël të synuar: Fondi është projektuar për investitorët e vegjël të cilët dëshirojnë ta mbajnë produktin gjatë periudhës së propozuar të investimit, janë në gjendje të përballojnë humbje të mundshme si pasojë e lëvizjeve të tregut (toleranca e humbjes është mesatare) gjatë ose në fund të periudhës së rënë dakord, kanë tolerancë mesatare-të ulët ndaj rrezikut, si dhe njohuri dhe/ose përvojë mesatare rreth këtij produkti ose produkteve të ngjashme. Në Hungari, Kuotat e Fondit të emetuara nga Fondi mund të blihen nga persona fizikë dhe juridikë, rezidentë dhe jorezidentë, me përjashtim të qytetarëve amerikanë, me kusht që të përmbushin rregullat e përcaktuara në kushtet e përgjithshme të ofertës. Sipas detyrimeve ligjore, ky dokument, Prospekti i Fondit dhe Rregulloret e Administrimit të Fondit, si dhe raportet për qëllime të informimit periodik, Njoftimet e Jashtëzakonshme, njoftimet dhe informacionet e Fondit për shpërndarjet tek investitorët, publikohen pa pagesë, në hungarisht, në faqen e internetit të Fondit, në faqen e produktit të Fondit (<https://www.otpalapkezelzo.hu/en/investment-funds/types/mixed/multi-asset-conservative>) nën menynë "Shkarkime" dhe nën menynë "Njoftime" (<https://www.otpalapkezelzo.hu/en/updates/announcements>).

Tregtimi i kuotave të Fondit: Kuotat e Fondit tregtohen vazhdimisht. Mund t'i shisni kuotat e Fondit tuaj gjatë tregtimit të vazhdueshëm përpara përfundimit të afatit të rekomanduar të investimit sipas kushteve të përgjithshme të specifikuara në njoftimet bazë të publikuara nga shpërndarës të ndryshëm. Kuotat e Fondit mund të blihen dhe të shiten në çdo ditë tregtimi gjatë orarit të punës së pikave të shitjes. Në rastin e blerjes ose të shitjes së kuotave të Fondit, dita e pagesës së transaksionit është dita e tretë e punës pas ditës së lidhjes së kontratës. (Dita e finalizimit të transaksionit +4).

Rreziqet e lidhura me produktin dhe çfarë mund të marr në këmbim



Treguesi i rrezikut supozon se do e mbani produktin për 4 vite.

Raporti i rrezikut të agreguar tregon nivelin e rreziqeve të lidhura me Fondin në krahasim me produktet e tjera. Ai tregon probabilitetin që Fondi të gjenerojë një humbje financiare si pasojë e lëvizjeve të tregut, ose për shkak se OTP Fund Management Ltd. nuk mund të bëjë pagesa për shkak të paftësisë paguese. Ky produkt klasifikohet në kategorinë 3 nga 7, e cila është një kategori rreziku mesatar në të ulët. Ky tregues i klasifikon si mesatare humbjet e mundshme nga performanca në të ardhmen. Nuk ka gjasa që kushtet e pafavorshme të tregut të ndikojnë në aftësinë e OTP Fund Management Ltd. për t'ju paguar. Kapitulli 26 i Politikës së Administrimit të Fondit përfshin një shpjegim të detajuar të rreziqeve që lidhen me fondin. Rreziku real mund të variojë ndjeshëm nëse i shisni kuotat e fondit përpara përfundimit të periudhës së rekomanduar të investimit dhe madje mund të merrni mbrapsht një shumë më të vogël. Kuotat e investimit të Fondit janë të shprehura në një monedhë të ndryshme nga monedha zyrtare e shtetit anëtar në të cilin janë emetuar. Për rrjedhojë, vlera e kthimit e shprehur në monedhën zyrtare

të shtetit anëtar në të cilin janë emetuar kuotat, mund të ndryshojë në varësi të luhatjeve të kursit të këmbimit. Ky rrezik nuk merret në konsideratë në treguesin e mësipërm.

Kini parasysh se vlera e kthimit dhe performanca e Fondit në të kaluarën nuk garantojnë performancën dhe vlerën e tij të kthimit në të ardhmen. Faktori i përmendur i rrezikut nuk mbetet domosdoshmërisht i njëjtë dhe mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Madje, as investimet me rrezikun më të ulët nuk janë tërësisht pa rrezik. Ky produkt nuk mundëson mbrojtje nga ndryshimet e ardhshme negative në performancën e tregut. Për rrjedhojë, investitorët mund të humbin një pjesë ose, në raste ekstreme, të gjithë investimin e tyre.

Skenarët e performancës:

Kjo tabelë tregon shumat që mund të merrni në fund të vitit të parë, ose nëse e mbani produktin deri në maturim, nëse investoni për shembull një shumë prej 10 000 euro.

Skenarët		1 vit	4 vite (periudha e rekomanduar e mbajtjes)
Skenari i stresit	Kjo është shuma që do të merrni mbrapsht pas zbritjes së kostove (në euro)	9,245	8,927
	Kthimi vjetor mesatar	-7.55%	-2.80%
Skenari i pafavorshëm <i>Ky lloj skenari i referohet një investimi të bërë ndërmjet periudhës 07/2021 – 07/2025</i>	Kjo është shuma që do të merrni mbrapsht pas zbritjes së kostove (në euro)	9,276	10,197
	Kthimi vjetor mesatar	-7.24%	0.49%
Skenari i moderuar <i>Ky lloj skenari i referohet një investimi të bërë ndërmjet periudhës 10/2014 – 10/2018</i>	Kjo është shuma që do të merrni mbrapsht pas zbritjes së kostove (në euro)	10,430	11,427
	Kthimi vjetor mesatar	4.30%	3.39%
Skenari i favorshëm <i>Ky lloj skenari i referohet një investimi të bërë ndërmjet periudhës 12/2016 – 12/2020</i>	Kjo është shuma që do të merrni mbrapsht pas zbritjes së kostove (në euro)	10,649	12,268
	Kthimi vjetor mesatar	6.49%	5.24%

Fondi nuk ka një kthim minimal të garantuar. Ju mund të humbni një pjesë ose të gjithë investimin tuaj. Skenarët e mësipërm ju tregojnë se si mund të performojë investimi juaj. Këto shifra mund t'i krahasoni me skenarët e produkteve të tjera. Skenarët e paraqitur më sipër janë përlogaritje të performancës së pritshme të investimit tuaj në të ardhmen në bazë të ngjarjeve të kaluara; ata nuk janë tregues të saktë. Shuma që do të merrni në kthim do të varet nga performanca e tregut dhe kohëzgjatjes së periudhës së mbajtjes. Skenari i stresit tregon shumën që mund të merrni në rrethana ekstreme të tregut, pa marrë në konsideratë mundësinë që emetuesi të mos jetë në gjendje të paguajë. Skenarët e pafavorshëm, të moderuar dhe të favorshëm, të paraqitur më lart, janë ilustrime duke përdorur performancën më të keqe, mesatare dhe më të mirë të Fondit gjatë 10 viteve të fundit. Zhvillimet e tregut në të ardhmen mund të ndryshojnë ndjeshëm. Shifrat e mësipërme përfshijnë të gjitha kostot vetjake të produktit, por nuk përfshijnë kostot që i paguani këshilltarit ose shpërndarësit tuaj. As mjedisi juaj i veçantë i tatimit nuk reflektohet nga shifrat e mësipërme, çka ndikon gjithashtu në shumën që do të merrni.

Çfarë ndodh nëse "OTP Fund Management" nuk mund t'ju paguajë?

Në rast të paafetësisë paguese të Shoqërisë Administruese të Fondit, investitori nuk do të pësojë asnjë humbje financiare, pasi shuma e investuar, pra aktivet e administruara në Fond, administrohen veçmas nga Depozitari i Fondit. Fondi është një subjekt ligjor i pavarur dhe nuk mban përgjegjësi në rast të mospërbushjes nga Shoqëria Administruese e Fondit ose nga një ofrues shërbimi (p.sh. depozitari, shpërndarësi).

Megjithatë, nëse Fondi për Mbrojtjen e Investitorëve (BEVA) nuk mund të sigurojë Njësinë e Investimit të investitorit ose aktive të tjera (tituj, para) të regjistruara në emër të investitorit, ofruesi i shërbimit i kontraktuar nga investitori do të jetë përgjegjës për të dëmshpërblyer investitorin. Nëse Depozitari ose partneri financiar, si një anëtar i BEVA-s, nuk mund të përmbushë detyrimet e tij dhe investitori nuk ka akses tek instrumentet financiare të depozituara, BEVA mund të mbulojë humbjen e investitorit. BEVA do të paguajë kompensim deri në maksimumi 100 000 euro për person dhe për anëtar të BEVA-s, së bashku. Mund të gjeni detaje të mëtejshme për skemën e garancisë për mbrojtjen e investitorëve të BEVA-s në faqen e internetit <https://bva.hu/hu>. Megjithatë, sigurimi i ofruar nga BEVA nuk mbulon asnjë humbje që rezultojnë nga performanca tregtare e Fondit.

Kostot që do të shkaktohen

Personi që ju shet produktin ose që ju këshillon në lidhje me të, mund të faturojë edhe kosto të tjera. Në këtë rast, ata ju informojnë rreth kostove të tilla, duke ju treguar se si kosto totale do të ndikojë në investimin tuaj me kalimin e kohës.

Reduktimi i kthimit (RIY) tregon ndikimin që ka kosto totale që do të paguani në të ardhurat që mund të fitoni. Kosto totale përfshin kostot e njehershme, aktuale dhe ato shtesë.

Shumat e shfaqura këtu janë kostot kumulative të vetë produktit, të llogaritura për dy periudha të ndryshme të mbajtjes. Ato përfshijnë gjithashtu çdo penalitet për dalje të hershme. Shifrat bazohen në një investim të supozuar prej 10 000 euro. Shifrat llogariten në bazë të skenarit të performancës së moderuar dhe mund të ndryshojnë me kalimin e kohës.

Ndryshimet e ardhshme të kostove

Tabela tregon shumat që do të përdoren nga investimi juaj për të mbuluar lloje të ndryshme të kostove. Këto shuma varen nga vlera që investoni, kohëzgjatja e mbajtjes së produktit dhe performanca e produktit. Shumat e shfaqura këtu janë ilustrime të bazuara në një shembull investimi dhe në periudha të ndryshme të mundshme të investimit. Ne kemi supozuar se do të merrni mbrapsht shumën e investuar në vitin e parë (kthim vjetor 0%). Për periudhat e mbetura të mbajtjes, kemi supozuar se produkti performon sipas skenarit të moderuar.

Ndryshimet e kostove me kalimin e kohës	Nëse e tërhiqni investimin tuaj (pas 1 viti)	Nëse e tërhiqni investimin tuaj (në fund të periudhës së rekomanduar të mbajtjes).
Kosto totale	159,35 euro	639,93 euro
Ndikimi vjetor i kostos*	1,56%	1,56% çdo vit

* Kjo ilustron mënyrën se si kostot reduktojnë kthimin tuaj çdo vit gjatë periudhës së mbajtjes. Kjo tregon, për shembull, se nëse ju dilni pas periudhës së rekomanduar të mbajtjes, kthimi vjetor mesatar pritet të jetë [4,95]% përpara kostove dhe [3,39]% pas kostove.

Përbërja e kostove

Tabela e mëposhtme tregon ndikimin vjetor të llojeve të ndryshme të kostove në kthimin e mundshëm të investimit tuaj në fund të periudhës së rekomanduar të mbajtjes. Në tabelë jepet gjithashtu kuptimi i kategorive të ndryshme të kostove.

Kostot e njërshme në hyrje ose dalje		Nëse e tërhiqni investimin pas periudhës së rekomanduar të mbajtjes
Tarifat e hyrjes	Shoqëria Administruese e Fondit nuk faturon tarifë hyrjeje. Sipas Politikës së Administrimit të Fondit: - në rastin e Shpërndarësit Kryesor, komisioni i blerjes është maksimumi 5% e shumës së investuar, por jo më tepër se 250 euro. - në rastin e bashkë-shpërndarësve, komisioni i blerjes është maksimumi 5% e shumës së investuar. Personi që shet produktin do t'ju informojë mbi normën faktike.	250 euro 500 euro
Tarifat e daljes	Shoqëria Administruese e Fondit nuk faturon tarifë daljeje. Sipas Politikës së Administrimit të Fondit: - në rastin e Shpërndarësit Kryesor, komisioni i tërheqjes është maksimumi 5% e shumës së tërheqjes, por jo më tepër se 250 euro. - në rastin e bashkë-shpërndarësve, komisioni i tërheqjes është maksimumi 5% e shumës së tërheqjes. Personi që shet produktin do t'ju informojë mbi normën faktike.	250 euro 500 euro
Kostot aktuale [çdo vit]		
Tarifat e administrimit dhe shpenzime të tjera administrative ose operative	Kosto e administrimit, tarifat e shpërndarjes, auditimit, depozitarit, kontabilitetit etj., përbëjnë 1,56% të vlerës vjetore të investimit tuaj. Kjo është një përllogaritje në bazë të kostove faktike të vitit të kaluar. (Ndikimi i kostove që ne faturojmë çdo vit për administrimin e investimeve tuaja)	156 euro
Kostot e transakcionit	Tarifat e administrimit të portofolit përbëjnë 0,00% të vlerës vjetore të investimit tuaj. (Kjo është një përllogaritje e ndikimit të kostos së blerjes dhe shitjes nga ana jonë e investimeve që qëndrojnë në themel të produktit. Shuma faktike do të luhatet në varësi të sasisë së blerë dhe të shitur).	0 euro
Kostot shtesë të shkaktuara në kushte të specifikuar		
Tarifat e performancës [dhe fondet tepçicë]	Për këtë produkt nuk paguhen tarifa performance.	

Kostot e mësipërme bazohen në të dhënat historike dhe mund të ndryshojnë me kalimin e kohës.

Për sa kohë duhet ta mbaj produktin dhe si mund t'i aksesoj paratë e mia më herët?

Afati kohor i investimit i rekomanduar nga Shoqëria Administruese e Fondit: 4 vite. Periudha minimale e rekomanduar e mbajtjes përcaktohet kryesisht në bazë të luhatjeve të pritshme të çmimit të fondit të investimit. Mund t'i shisni kuotat e Fondit tuaj gjatë tregtimit të vazhdueshëm përpara përfundimit të afatit të rekomanduar të investimit sipas kushteve të përgjithshme të specifikuar në njoftimet bazë të publikuara nga shpërndarës të ndryshëm. Vlera reale e rrezikut ose e performancës mund të ndryshojë ndjeshëm nëse e tërhiqni produktin përpara përfundimit të periudhës së rekomanduar të mbajtjes.

Si mund të dorëzoh një ankesë?

Ankesat në lidhje me veprimet e personit që ju informoi për një produkt, ose që ju shiti një produkt, mund t'i dorëzohen atij personi (p.sh. ndërmjetësit tuaj). Ankesat në lidhje me një produkt ose me veprimet e personit që krijoi produktin mund t'i komunikohen Shoqërisë Administruese të Fondit, në format e paraqitura më poshtë në detaje: **Fizikisht ose me anë të një përfaqësuesi të autorizuar** te selia e regjistruar e Shoqërisë Administruese të Fondit (H-1026 Budapest, Riadó u. 5–11); ose me telefon në numrin +36-1-412-8309, mes orës 08:00 dhe 16:00 në çdo ditë pune, si dhe mes orës 08:00 dhe 20:00 në ditën e parë të punës së javës. Dokumentet që përmbajnë **ankesa me shkrim** mund të dorëzohen fizikisht ose përmes palëve të treta te selia e regjistruar e Shoqërisë Administruese të Fondit, ose me postë në adresën: OTP Fund Management Ltd.: 1026 Budapest, Riadó u. 5-11., me email në: panasz@otpalapkezelo.hu; ose me faks (+36-1-412-8399), çdo ditë (24/7).

Detaje të mëtejshme të rëndësishme

Në përputhje me një detyrim ligjor, ky dokument, Prospekti dhe Politika e Administrimit të Fondit, të dhënat ditore të vlerës neto të aktiveve, raportet vjetore dhe gjashtëmujore, si dhe njoftimet zyrtare janë të disponueshme pa pagesë, në hungarisht, në pikat e shpërndarjes, në selinë e regjistruar të Shoqërisë Administruese të Fondit, në faqen e internetit të Shoqërisë Administruese të Fondit (<https://www.otpalapkezelo.hu/en/home>), në faqen e internetit të OTP Bank Nyrt., në cilësinë e shpërndarësit kryesor (www.otpbank.hu) dhe në faqen e internetit të MNB-së <https://kozzetetelek.mnb.hu>.

Viti i hapjes së Fondit, 2022

Performancën e fondit, që nga krijimi i tij (por maksimumi për 10 vitet e fundit) mund ta gjeni te menyja "Performance" e

fondit përkatës: <https://www.otpalapkezelo.hu/en/investment-funds/types/mixed/multi-asset-conservative>

Përllogaritjet e skenarëve të performancës së Fondit publikohen çdo muaj dhe janë të disponueshme në:

<https://www.otpalapkezelo.hu/en/documents/performance-scenarios>

Performanca në të kaluarën nuk është një tregues i besueshëm i performancës në të ardhmen. Tregu mund të pësojë ndryshime ekstreme me kalimin e kohës.

Kthimet vjetore të Fondit për Kuotat e Investimit të Serisë "A" janë kthime të llogaritura në euro dhe në llogaritjen e tyre Shoqëria Administruese e Fondit ka marrë në konsideratë tarifat aktuale të faturuara ndaj Fondit, por nuk ka marrë në konsideratë tarifat e njërshme të hyrjes dhe daljes.